

Duam kushte më të mira pune dhe pagat minimale!

Sektori i industrisë

Tanimë me paga minimale

2

Dita e grevës së grave

Fund dumpingut në paga

3

Konferenca për Kosovën

Drejtësia sociale dhe sindikatat

4

Nr. 4 | korrik 2013 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Demonstrata më 21 shtator


Të mbrohen pagat dhe pensionet!

Çdo ditë na arrijnë lajme nga punëmarrës/e, të cilët edhe përkundër orarit të plotë të punës nuk fitojnë mjaft. Në vazhdimësi diskutohet për shkurtrimin e pensioneve. Dhe natyrisht fajtorë janë përsëri të huajt: kaluesit e kufirit, migrantët e vjetër dhe ata të ri. Për këto arsye ne më 21 shtator themi: të mbrohen pagat dhe pensionet, të ndalen plaçkitësit dhe armiqësia kundër të huajve!

Presioni në paga në Zvicër është rritur dukshëm, rastet e shtypjes (dumpingut) të pagave po rriten. Ndalimi i imigrimeve, ashtu si duan të na e imponojnë të djathtët, nuk paraqet zgjidhje të problemit. Fajtori i vërtetë nuk është migranti, porse punëdhënësi, i cili dëshiron të pasurohet në kurriz të migrantëve dhe zviceranëve. Ne kemi nevojë më shumë për ligje të repta, më shumë kontrolle dhe sanksione të repta – ne kemi nevojë për masa mbrojtëse gjithëpërfshirëse. Ne kemi nevojë për paga minimale Dumpingu (shtypja) e pagave luftohet me pagën minimale. Zyrtarët zviceran dhe punëdhënësit lavdërojnë partneritetin social, megjithatë vetëm gjysma e punëmarrësve kanë KPP (Kontratë të Përgjithshme Punë) dhe jo të gjitha KPP parashohin pagën minimale. Në të vërtetë 1/3 e punëmarrësve që i nënshtrohen KPP, nuk kanë pagë minimale. Realiteti tregon se një arsimim profesional nuk siguron pagë ekzistenciale. Gati gjysmë milioni punëmarrës në Zvicër fitojnë më pak se 4000 franga në muaj – edhe përkundër orarit të plotë të punës. Kjo duhet të marrë fund: paga minimale duhet të sigurohet, posaçërisht për të përfituar edhe gratë dhe migrantët.

Fund plaçkitjes

Pos kësaj duhet dhënë fund pagave astronomike të menaxherëve. Iniciativa 1:12 e Juso-s (socialistëve të rijë) kërkon kufizimin e pagave të kuadrore më të larta. Paga më e lartë një ndërmarrjeje sipas kësaj iniciative nuk guxon të jetë dymbëdhjetë herë më e lartë se paga më e ultë etën jetës ndërmarrjeje. Për këtë iniciativë do të votohet sipas të gjitha gjasave në nëntor të këtij viti.



Fuqizim i AHV/AVS në vend të vjedhjes së pensionit

12 herë më shumë për shefat mjafton

mbrojtje nga dumpingu në paga

paga minimale 4000 franga

Të gjithë në demonstratë më 21 shtator për paga dhe pensione më të mira!

Të fuqizojmë kolonën e parë të sigurisë shoqërore (AHV/AVS)

Kush tërë jetën kryen punë të rëndë, duhet në pleqëri të bëjë jetë korrekte. Këtë parashih kështu kushtetuta e Zvicrës. Mirëpo realiteti duket ndryshe. Në vend të pagave më të larta, partitë e djathta duan të shkurtojnë pensionet. Këtë vjedhje të pensioneve ne nuk e përkrahim. Ne kërkojmë të fuqizohet kolona e parë e sigurisë shoqërore (AHV/AVS), ashtu si e kërkon dhe parashih edhe iniciativa AHVplus.

Votimi i 22 shtatorit:

Jo orarit të punës 24 orësh!

Me një ndryshim të ligjit të punës parti të e djathta duan të bëjnë realitet orarin 24 orësh të punës në tregti të imët. Për këtë do të votohet më 22 shtator në rrafshin federal. Për të punësuarit kjo domethënë me shumë stres, më pak kohë të lirë dhe më pak kohë për familje. E tërë kjo me paga tepër të ulëta. Nëse shitoret janë të hapura pandërprerë,

atëherë edhe sektorët tjerë do të kenë orarin 24 orësh të punës. Andaj për këtë duhet votuar JO më 22 shtator!

✉ Aurora Garcia



Ejani të gjithë në demonstratën gjithë-zvicerane më 21 shtator 2013, në ora 13.30 në Bernë. Më shumë informacione mund të merrni në sekretariatit Tuaj të Unia-s.

Editorial



Të dashur/a lexues/e

Mjerisht ndodhi ajo që është pritur: Populli zviceran përsëri i tha po vështirësimit të ligjit për azil drejt përkeqësimit të drejtës së migrantëve. Tradita e famshme e Zvicrës gjithmonë ka qenë më shumë me se sa realitet.

Frika ka kapërthyer keqas shoqërinë zvicerane, ashtu si shumë pjesë të Evropës. Në fund të fundit nuk ka më thjeshtë se sa të panjohurës dhe të pafuqishmëve tu hidhet faji për problemet e vetë shkaktuara vendore. Kjo u tregua rishtas me 9 qershor. Nëse shikohen me vëmendje rezultatet e votimit, aprovimi më i lartë (mbi 80%) ishte në ato regjione ku jetojnë më së paku të huajt. Nëse pas një numri nuk kemi një emër dhe një histori, atëherë është e thjeshtë që këtë person të mos e perceptojmë si njëri dhe atë ta paraqesim si fajtor. Ka kohë që të huajt shërbejnë si fajtor kujdestar. Edhe politikanët janë të paralizuar nga frika. Askush nuk ka guxim të zbatojë një politikë korrekte migracionit dhe me dinjitetet. Përkundrazi vijojnë të fuqizohen zgjidhje false si qendrat për azilkërkues të pabindur, të cilat është e pamundur të zbatohen, apo vendime për klauzola-ventile, edhe pse ato janë pa ndikim. Në të vërtetë për procedurë të shpejtë të përpunimit të kërkesave për azil nevojitet me shumë personel dhe jo reduktim, ashtu sikur kërkojnë politikanët të djathtët, apo fuqizim të njëmend të masave shtesë, për të cilat nuk mendon askush. Natyrisht se është shumë i vogël numri i politikanëve, të cilët janë për pagën minimale dhe për participimin politik të migrantëve, nga të cilat dhe para së gjithash do të përfitonin vetë zviceranët. Një politik e mirë migracioni dhe me ndikim pozitiv d.m.th. posaçërisht, që të gjithë duhet të kenë të drejta të njëjta, zviceranët ashtu sikur edhe migrantët.

Aurora Garcia

Sekretare për migracion dhe anëtare e redaksisë

News

Konferenca e qershorit për Migracion në Unia

Rreth 40 delegatë morën pjesë në konferencën sivjetmë për migracion. Si mysafir referojë Tarek Naguib mbi temën diskriminimi në Zvicër, e më pas bashkëkryetari Giovanni Gerrana raportoi mbi udhëtimin e delegacionit të Unia-s në Forumin social botëror, ndërsa bashkëkryetaria e komisionit për migracion mbi protestat në Turqi rrethë përqark Gezi-Park-ut. Delegatët aprovuan një qëndrim mbi ventil-klauzolën. Në këtë qëndrim kritikohet politika e qeverisë mbi këtë temë. Në fund u aprovua një rezolutë kundër mbylljes së zyrës së konsullatës spanjolle në Bazël dhe reduktimi i kurseve të gjuhës dhe kulturës amtare.

Më shumë pagë për berberë (flokteri)

Sektori i floktarisë posedon një Kontratë të Përgjithshme të Punës. Në rundin e dytë CoiffureSUISSE aprovoi KPP-në në fund të muajit maj. Përmes kësaj pagat minimale do të ngritën deri në vitin 2015 hap pas hapi në 3800 franga, gjë që paraqet një rritje prej 12%. Ky është një hap i parë i rëndësishëm kundër pagave tejet të ulëta në këtë sektor. Për sindikatën është i kënaqshëm edhe përmirësimi si ai përket rregullimit të pushimeve dhe rritja e kontrollit sa i përket zbatimit. Paga minimale në industrinë e orëve Pas bisedimeve gjatë mujore partnerët social kanë arritur pajtueshmëri për rritjen e pagës fillestare minimale në industrinë orëve. Sipas regjionit ato rriten për 0.85% deri më 2%. Më së shumti janë bërë rritje në regjionet që deri më tani kanë pasur pagat më të ulëta. Sindikat Unia më këtë ia ka arritur të nxjerrë dyfishin e ofertës së punëdhënësve. Për të ndaluar dumpingun e shfrenuar të pagave këto rritje megjithatë janë ende të pamjaftueshme. Unia do të kërkojë rritje substanciale edhe në vitin 2014.

Parlamenti i mjit i ndërtimtarëve të Unia-s

Parlamenti i ndërtimtarëve të Unia-s me rreth 120 pjesëmarrës u mbajturi në Bernë kërkoi që firmat e ndërtimit të respektojnë rregullat ligjore dhe punëtorëve të tyre tu vejnë në dispozicion falas rrobat e përshtatshme të punës dhe këpucët e sigurisë. Për përmirësim të mbrojtjes nga dumpingu i pagave pjesëmarrësit kërkuan masa gjithëpërfshirëse shtesë dhe zbatim të detyrueshëm të përgjegjësive solidarë. Pos tjerash u zgjosh edhe drejtorja e re e sektorit: Drejtues sektori Nico Lutz, ndërsa anëtarë tjerë janë: Rita Schiavi, André Kaufmann, Roland Schiesser, Hansueli Scheidegger si dhe Serge Gnos.

Sektori i industrisë me KPP të re

Për herë të parë paga minimale në industri

Në Kontratë e re të Përgjithshme të Punës për industrinë e makinave, atë elektrike dhe metalike për herë të parë përcaktohen pagat minimale. Ka 75 vite që punëmarrësit kanë bllokuar tërësisht pagat minimale me KPP. Tani u arrit ky përparim.



Pamje nga demonstrata e fundit punonjësve të industrisë

Rezultati i bisedimeve tani duhet të aprovohet nga organet përgjegjëse të partnerëve social. Delegacioni për negociatën e sektorit të industrisë i sindikatës Unia rezultatin e konsiderojnë të kënaqshëm.

Negociata të vështira

Ankorimi i pagave minimale që nga fillimi ishte nga kërkesat qendrore të Konferencës së sektorit të industrisë MEM në sindikatën Unia, si kusht për arritjen e një Kontratë të Përgjithshme të Punës. Fillimisht

bllokonte shoqata e punëdhënësve «Swissmem» në mënyrë rigorozë kërkesat për pagë minimale në KPP, edhe pse vetëm pagat minimale dhe krijimi i arsimimit profesional të dyfishtë atraktiv do të plotësonte mungesën e personelit profesional

Tregtia me pakicë

Grevë në sektorin e tregtisë: Ne kemi më shumë vlerë!

Në sektorin e shitblerjes ka grevë, bile edhe të suksesshme: Që nga 1 maji të punësuarit në Metro Boutique – pas një greve paralajmëruese më 17 prill – kanë një marrëveshje që me veti bie edhe kushte më të mira pune. Edhe të punësuarit në Spat Dättwil në kanton Aargau kanë hyrë në një grevë të pakufizuar, pasi që nuk janë të gatshëm të punojnë në kushte tejet të këqija të punës.

duhet pos tjerash të jenë në dispozicion 100% për zëvendësime dhe të gatshme në çdo kohë për punë. Pos tjerash shitëset nuk marrin pagën e 13-të dhe bile ju duhet të punojnë 20 minuta falas më gjatë në javë.

S'ka më punë falas

Kësaj i ka ardhur fundi. Pas dy rundeve bisedash të pasuksesshme dhe pas një greve paralajmëruese u nënshkrua një Marrëveshje, e cila parashihet një rritje rroge prej 400 frangash, eliminimin e «punës falas» si dhe mbrojtje më të mirë të vendit të punës dhe themelimin e një komisioni të personelit. Megjithatë është e qartë se vetëm një Kontratë e Përgjithshme e Punës, e cila i eliminon stërkeqet në këtë sektor.

Grevë tek Spar-Dättwil

Gjithashtu stërkeqe të kushteve të punës i njohin edhe punonjësit e pikës së shitjes edhe të karburanteve tek Spar në Dättwil: Mungesa e per-

sonelit dhe pagat e ulëta i takojnë përditshmërisë. Punonjësit e Spar për këtë arsye iu janë drejtuar menaxherët e Spar, ndërsa në terminin e dytë përfaqësuesit e bisedimeve të Spar edhe përkundër përafrimeve të pozicioneve i ndërprejnë bisedimet.

Më shumë respekt

Në rastin e Spar greva vijon edhe më tej deri sa të gjendet një zgjidhje. Përpasororit me orë e tepërta të paligjshme të punës, vijnë edhe rrogat e këqija. Shumë tëpunësuar me arsimim të kryer profesional marrin pagë sikur të ishin të pa arsimuar. Pastaj sikur në rastin e Matro Boutique, shumica e të punësuarve kanë kontratë më së shumti 80% të punësimit, me një pagë mujore bruto prej 2880 frangave.



Pamje nga ditët e para të grevës në Dättwil



Solidaritët i gjerë me grevistët e Spar-it



Punonjësit grevistë meritojnë më shumë respekt

Arsimimi i mëtejshëm profesional

Progredir II u dedikohet të gjithë migranteve!

Kursi i ri, i cili mundëson njohjen e përvijës profesionale të punëmarrësve nga sektori i pastrimit dhe gastronomisë, starton këtë vjeshtë në Kantonin Waadt.

Pas suksesit të pilot projektit «Progredir» të Unia-s dhe të institutit arsimor ECAP, i cili realizohet nga viti 2009 në kantonin Waadt, do të startojë në shtator të vitit 2013 me një cikël të ri kursit. Progredir II, ashtu sikur edhe projekti paraprak, një program i cili u dedikohet migranteve, të cilat duan të ju njihet përvoja profesionale. Me këtë rast ato, pas përfundimit të programit përkatës të zhvilluar enkas për to, munden të marrin dëshminë e tes-

tit shtetëror (EBA), apo dëftesën mbi aftësinë profesionale (EFZ), me çka përmirësojnë situatën e tyre në tregun e punës sikur edhe pagën e tyre.

Progredir II

Pilot projekti ishte i kufizuar vetëm për migrantet portugeze. Progredir II përkundrazi është i hapur për të gjitha migrantet, pavarësisht prejardhjes së tyre dhe pavarësisht se a janë të punësuar apo janë në kërkim të

një vendi pune në sektorin e pastrimit dhe gastronomisë. Pas bilancit të kompetencave për çdo pjesëmarrëse të kursit do të përcaktohet rruga arsimore. Ky rrugëtim arsimor përbëhet disa module, posaçërisht një kurs në gjuhën frënge, i cili çdo pjesëmarrëseje i mundëson të përmirësojë njohurit gjuhësore në sektorët përkatës. Kësaj i shtohet moduli i njohurive të përgjithshme, kurse nxënieje të kompetencave themelore, si dhe kurse për teknikat relevante të sektorit. Qëllimi i këtij arsimimi dyvjeçar profesional, kurset e të cilit zhvillohen mbrëmjeve dhe të shtunave, mundëson pjesëmarrjen në provimet shtetërore me qëllim që mbështetur në ligjin federal mbi arsimimin profesional (BBG) të vitit 2004 të marrin dëshminë EBA apo dëftesën EFZ.

Njëmbëdhjetë gra kanë marrë dëftesat profesionale, një grua ka marrë dëshminë shtetërore. Katër gra do të hyjnë sivjet në provim, ndërsa tri tjera në vitin 2014», thotë e kënaqur Amilcar Cunha, përgjegjësja e Projektit Progredir në Unia Waadt. Ajo shprehet se shumë gra do ta shfrytëzojnë këtë shans për të përmirësuar situatën e tyre. Marrja e dëftesës profesionale ka të bëjë me sektorët e hotelierisë dhe mirëmbajtjes së ndërtesave. Një grua pos kësaj ka arritur të marrë dëftesën edhe EFZ në ekonominë shtëpiake, ndërsa një grua tjetër ka arritur të marrë dëftesën e asistentes për tregtim të imtë. Këto dy profesione për shkaqe organizative nuk janë të mbuluara në ciklin e ardhshëm. Këto kurse do të mbahen në Lozanë apo Vevey, ndërsa orari i saktë do të përpilohet mbështetur në mundësitë pjesëmarrëseve. Informata të mëtejme mund të gjeni në faqen e internetit të projektit: www.progredir.ch.

12 gra kanë arritur të kualifikohen

«Pilot projekti ynë është një sukses, falë angazhimit të të gjithëve, posaçërisht falë pjesëmarrësve të kursit.



Gratë portugeze pjesëmarrëse ne kursin e Progredir

14 qershori: Dita e grevës së grave 2013

Fund dumpingut të pagave tek gratë



Pamje e demonstratës së sivjetme me 13 qershor në sheshin federal

Edhe njëherë gratë, me rastin e 22 vjetorit «të 14 qershorit», festuan për më shumë pagë dhe për barazi. Në vijim do tu prezantojmë një raport mbi aksionet e sivjetme të Komisionit për Gra të Unionit të Sindikatave të Zvicrës, i cili u zhvillua më 13 qershor në sheshin federal në Bernë.

Më 13 qershor gratë demonstuan për barazi në paga, dhe për pagën minimale. Gratë u mbledhën në ora 12.30 në sheshin federal para ndërtesës së Parlamentit, ku ato ua tërhoqin vëmendjen parlamentarëve për preokupimet dhe kërkesat e tyre, të cilat ka vite që nuk po realizohen. Gratë kishin shkruar kërkesat e tyre nëpër transparente në të tri gjuhët vendit dhe shpërndanë edhe afishe. Përfaqësueset e sindikatave mbajtën edhe fjalë rasti.

Parlamentarët të cilët ngutshin për të drekuar, u takuan me demonstruesit. Parlamentarët nga radhët e partive të djathta nuk donin të dëgjonin për kërkesat e grave dhe kthenin kokën anash. Parlamentarët, të cilët mbështesin fuqishëm kërkesat e grave solidarizoheshin me demonstruesit.

Pagë minimale për të gjithë! Corinne Schärer, anëtare e drejtorisë qendrore të sindikatës Unia, në fjalët saj potencoi: «Pagat e ulëta dhe

ngecja me dhjetëra vite e barazisë në paga, është realiteti i hidhur për gratë – gjendje kjo e papranueshme: Edhe pse Kushtetuta dhe Ligji ndalon diskriminimin në paga, nuk kemi asnjë përparim në këtë çështje. Shqyrtimi vullnetar i pagave si duket nuk mjafton. Andaj Unia kërkon kontrolle sistematike dhe të detyrueshme.» Derisa gratë sikur në shitblerje (60000 gra janë të punësuar në këtë sektor) edhe përkundër punësimit të 100% ju duhet të punojnë për një pagë nën 4000 franga dhe me këtë rast fitojnë 633 franga më pak se kolegët e tyre, andaj gratë bashkë me sindikatat e tyre do të luftojnë edhe më tej deri sa të fitojnë të drejtat e tyre.

Emine Sariaslan

Rezistenca në Turqi

Liria e mendimit, demokracia, të drejtat e njeriut

Në Turqi aktualisht është formuar një lëvizje e gjerë sociale e demokratike. Shkaktar ishte rindërtimi në «Gezi-Park» – një nga parqet e pakta të mbetura në zemër të qytetit. Sipas planeve të qeverisë (AKP) edhe ky park duhet të ndryshojë në një qendër shitblerjeje dhe kompleksi ndërtesash. Për herë të parë në historinë e re të Turqisë grupe të ndryshme kanë arritur që të bashkohen në korniza të gjëra dhe jashtë kohës së zgjedhjeve të ndryshojnë gjërat.



Pamje nga protestat paqësore për më shumë demokraci të qytetarëve në Turqi

Kështu demonstuan të gjithë bashkë për drejtësi arsimore dhe perspektiva jetësore, për barazi, kundër varfërisë dhe kundër politikës qeveritare armiqësore karshi grave. Sindikatat DISK, KESK, TMMOB, TTB dhe TDB kanë bërë thirrje për një grevë të përgjithshme. Me mijëra punëtorë kanë ndaluar punën. Poli-

cia ndërhyri duke rrahur dhe sulmuar demonstruesit me topa uji dhe gaz lotsjellës. Tre demonstrues u vranë, 12 protestues humbën sytë, me mijëra janë të lënduar. Nga ngjarjet janë politizuar me mijëra të rijë, gjë që mund të ndikoi në kthesa në Turqi. Demonstratat janë duke u zgjeruar në tërë Turqinë.

Intervenim brutal policor

Një delegacion nga Zvicra i përbërë nga politikanë të partisë Socialdemokrate, sindikata Unia dhe grupimi i majtë politik Basta udhëtoi për në Turqi, për të parë gjendjen drejtpërdrejtë. Një anëtarë i këtij delegacioni më 16 qershor deklaroi përmes telefonit ndër të tjera se: «...ai ishte shumë i prekur nga pamjet me rastin e intervenimit brutal masiv dhe të pandërprerë policor karshi protestuesve paqësor. Situata është duke u përshkallëzuar ngjashëm me atë të luftës civile...».

Protesta solidariteti me bashkëvendësit e tyre u organizuan nga migrantët edhe nëpër vende të ndryshme të Zvicrës.

Emine Sariaslan



Ku ka tym ka edhe flakë!

Intervistë



André Kaufmann

Intervistë KPP për personel të huazuar

Këshilla për personelin e huazuar

Kontrata e Përgjithshme e Punës për personelin e huazuar ka hyrë në fuqi ka më shumë se një vit. Koha për të bërë bilanc. Me këtë rast epet mundësia për të dhanë disa këshilla punëdhënësve. Për këtë arsye kemi biseduar me André Kaufmann, anëtarë i drejtorisë së sektorit të ndërtimitarisë në Unia dhe kryetar i komisionit të paritetit për personel të huazuar. Më poshtë mund të lexoni pjesën e parë të intervistës. Pjesa tjetër vijon në Horizontin nr. 5.

André, përse ka qenë i nevojshëm fuqizimi i kësaj KPP?

Në ndërkohë është rritur numri i punëmarrësve që i takojnë personelit të huazuar, rreth 280000 punëtorë, të cilët vijnë nga sektorë të ndryshëm. Shumë nga këta sektor posedojnë një Kontratë të Përgjithshme të Punës me deklaram të detyrueshëm (AVE GAV). Apo thënë ndryshe, kushtet e punës për 2/3 e këtyre 280000 punëtorëve ka qenë pamjaftueshëm i rregulluar. Tani kjo ka ndryshuar.

A u nënshtrohen të gjithë të punësuarit temporal kësaj KPP-je?

Ky është një formulim i keq kuptueshëm. Nuk është relevante se a është kontrata e punës e kufizuar apo jo. Por se, a është punësuar punëtori përmes një firme që huazon personelin. Në ndërkohë kemi shumë punëmarrës me kontrata të pakufizuara pune.

Sa mirë mund të funksionojë një KPP e tillë e sektorëve gjithëpërfshirës?

Në të vërtetë mjaft mirë. Në fakt nuk është e komplikuar: KPP për personel të huazuar përcakton kushtet minimale që duhet plotësuar. Mirëpo vlen parimi i prioritetit: në një sektor me KPP të deklaruar si obliguese (AVE GAV) vlejnjë rregullat e pagës dhe të orarit të punës (të AVG GAV), mirëpo jo ato të KPP për personel të huazuar. Pra, për punëtorët që punojnë në sektorin kryesor të ndërtimitarisë vlejnjë pagat dhe orari i punës ashtu sikur qëndrojnë në Kontratën Kombëtare të Punës. Megjithatë natyrisht kemi edhe probleme të caktuara.

Ku për shembull?

Në parim funksionon mirë, edhe për arsye se ne në KPP për personel të huazuar në përgjithësi kemi rregulla më të mira se sa në janë në të vërtetë në sektorët në fjalë. S ai përket përkujdesjes të pensionit profesional dhe arsimimit të mëtejshëm qëndrojmë shumë mirë. Mirëpo kemi edhe probleme: Paratë ditore në rast sëmundjeje. Pasi ne jemi duke diskutuar ku, sipas Nenit 3 Alineja 1, rregullat e KPP për personel të huazuar merren përsipër vetëm nëse ato janë të baras-vlefshme me rregullat e vlefshme për sektorët me Kontratën Kombëtare të Punës (AVE GAV). Ne pra jemi duke luftuar që rregullat e KPP-ve tjera, të cilat janë më të mira, të vlejnjë edhe për punëmarrësit, të cilët në të vërtetë iu nënshtrohen KPP për personel të huazuar...

Vazhdon në numrin tjetër...

KPP për personel të huazuar iu nënshtrohen të gjitha firmat, që janë anëtare të swissstraffing si dhe ato që nuk janë anëtare, nëse arrijnë shumën vjetore të pagave prej së paku 1,2 milion frangave.

Në parim vlen KPP për personel të huazuar. Megjithatë vlen paga minimale dhe rregullimi i orarit të punës të KPP të deklaruar si obliguese, si dhe nga 36 KPP-të të bashkangjitura në shtojcën 1 të KPP për personel të huazuar. Paga minimale nuk vlen në sektorët vijues: industria kimike-farmaceutike, industria e makinave, industria grafike, industria e orëve, industria ushqimore dhe ajo shijuese, komunikacioni publik.

Rregullat mbi përkujdesjen e pensionit profesional (BVG) dhe parave ditore në rast sëmundjeje (KTG) si dhe arsimimi i mëtejshëm, janë të përcaktuara sipas KPP për personel të huazuar. Kujdes, vlejnjë rregullat tjera e jo ato që vlejnjë për sektorët e zakonshëm. Kështu tek personeli i huazuar në rast sëmundjeje vlen: 2 ditë pritjeje, 80% të pagës! Shih Nenin 28 dhe 29 të KPP.

Më shumë informata gjeni në vegën: www.tempdata.ch (në gjuhët vendore, bashkë me llogaritësin e pagës).

Konferenca në Bernë

Drejtësia sociale në Kosovë

Të shtunën, më 15.6.2013 në Bernë të Zvicrës, organizuar nga sindikata Unia dhe Fondacioni Solifonds dhe mbështetur edhe nga Solidar Suisse u mbajt një manifestim mbi situatën e sigurisë sociale në Kosovë. Në këtë tubim të moderuar nga historiani zviceran dhe njohësi i lëvizjes punëtore Hans Schäppi, njëherazi edhe kryetar i Fondacionit Solifonds, përpos zviceranëve e shqiptarëve pati pjesëmarrës edhe nga radhët e migrantëve italian, portugez, etj., e të cilët u inkuadruan aktivisht dhe me pyetjet dhe diskutimet e tyre pasuruan këtë manifestim.

Me këtë rast u mbajtën dy referate, njëri nga Max Brym, themelues i gazetës elektronike Kosova-Aktuell dhe ligjërues i kohëpaskohshëm në fakultetin filozofik të Universitetit të Kosovës, ndërsa tjetri nga Osman Osmani, sekretar për migracion në Unia dhe anëtar i komitetit për politikë sociale në Lëvizjen Vetëvendosje! Më pas u zhvillua një tryezë diskutimi ku morën pjesë edhe Barbara Burri Sharani, ish drejtuese e zyrës zvicerane për zhvillim e bashkëpunim në Kosovë dhe aktualisht menaxhere projektesh në Solidar Suisse dhe Ruzhdi Ibrahim, specialist i sigurimeve shoqërore dhe i punësuar në Arkën e sigurimit të papunësisë në Unia të Bazelit. Sikur për referatat ashtu edhe për diskutimet e këtij manifestimi u bë përkthim simulan në të dy gjuhët, gjermanisht dhe frëngjisht.

Kosova nuk duhet të shërbejë si eksperiment neoliberal

Max Brym në referatin e tij kritikoi rreptë procesin privatizues në Kosovë. Sipas tij procesi privatizues Kosovës i kushtoi 76000 vende të humbura pune. Mesatarisht sipas Brym me rastin e secilit privatizim humben 50% e vendeve të punës. Punëtorët e mbetur në ndërmarrjet e privatizuara nuk gëzojnë kurrfarë të drejtash. Përmes shembujve konkret Brym atakoi procesin e privatizimit. Sipas tij «pasuria e vendit po falet». Ndërsa të tjera Brym tha: «Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) u privatizua para pak kohësh për 75%. PTK ishte ndërmarrja publike më rentabile e Kosovës: Vetëm mes viteve 2007 dhe 2011 PTK arriti të shënojë një fitim prej gati 400 miliona Eurosh. Tani PTK-ju iu bartë një firmë të dyshimtë AXOS GmbH në Hamburg për vetëm 277 milion. Shpërndarësi e rrymës KEK u bë rrush e kumbulla për vetëm 27 milion. Si pasojë u bë rritja enorme e faktuarave të rrymës në Kosovë».

Brym e vuri Kosovën në kontekstin e politikës neoliberale në Evropë, me ç'rast ai theksoj: «Kosova ishte dhe mbetet një eksperiment neoliberal në Evropë. Kosova është vendi më i varfër i Evropës, mirëpo gjithnjë e më shumë shtete në Evropë në kuadër të krizës kapitaliste po afrohen standardeve të Kosovës. Është e nevojshme rezistenca ndërkombëtare e lëvizjes punëtore kundër KOSOVARIZIMIT të pjesëve tjera të Evropës. Gjithkund duhet të ketë rezistencë sociale».



Pamje nga pjesëmarrësit e konferencës mbi situatën sociale në Kosovë



Në tryezë nga e majta: O. Osmani, Ruzhdi Ibrahim, Barabra Burri-Sharani, Max Brym, Hans Schäppi

Mbretëron situatë dëshpëruese

Në prezantimin vijues referuesi Osman Osmani, pasi bëri një pasqyrim të situatës së përgjithshme të vështirë sociale në Kosovë duke e pasqyruar atë edhe me shembuj aktual konkret, ai analizojë edhe situatën tejet të vështirë të sindikatave në Kosovë. Përfundimet e tij siç tha ai, mbështeten në hulumtimet dhe dokumentet programore të Lëvizjes Vetëvendosje, në rekomandimet historianit sindikalist Hans Schäppi mbështetur në përvojat reformuese të sindikatave në Zvicër si dhe në analizën dhe propozimet e masave konkrete për fuqizimin e sindikatave në Kosovë nga bashkëdrejtuesi i sindaktës Unia në Berneroblerland, Hilmi Gashi. Në vijim po shkëpusim pjesë nga fjala e tij: «Situata sociale e politike në Kosovë sa vjen e po bëhet më e rëndë. Gjysma e popullsisë është e papunë, pra, çdo i dyti person i moshës madhore në Kosovë, në anën tjetër edhe ata që punojnë, shumica e tyre mezi sigurojnë mbijetesën dhe nuk gëzojnë as të drejta minimale. Ndërsa sa për të ilustruar të arriturat drejt «perspektivës evropiane» të trumbetuar nga qeveritarët, po theksojmë fenomenin rrëqethës që ka kohë po e përcjell kohët e fundit po përcjell regionin e Anamoravës. Rreth 3000 qytetarë edhe të fshatrave të Vitisë, Gjilanit e Ferizajt me rrethine vetëm javën e fundit, kanë lënë thyqafas vendin përmes Serbisë në Hungari, me qëllim të arrijnë në njërin nga shtetet e zhvilluara të Evropës (Zvicra, Gjermania, Franca), për një jetë më të «mirë» dhe për të mbajtur familjet e tyre».

Për sindikata të mirëfillta në Kosovë

Ka kohë që sindikatat në Kosovë përballen me një krizë serioze: zvogëlimi i numrit të anëtarëve, ankorim i varfër para së gjithash në sektorin privat, ankorim i varfër në regjione, fragmentim (copëtim) i sindikatave, varësia nga partitë politike në pushtet, përfshirje në procesin e privatizimit dhe shpronësimit të pasurisë shoqërore.

U theksua nevoja e formulimit të një projekti sindikal me qëllime të qarta: Tejkalmi i copëzimit sindikal, ndërtimi ndër-profesional dhe ndër-sektorial, ankorim nëpër regjione, organizimi i shkretëtirave sindikale, rritja e aftësisë mobilizuese, pavarësia politike nga pushtetarët, përfortimi i bashkëpunimit me sindikatat e Shqipërisë, pastaj me ato të Evropës juglindore dhe në përgjithësi të Evropës dhe tërë Botës.

Në thumb edhe Marrëveshja mbi sigurimet shoqërore Zvicër – Kosovë

Në pjesën e dytë u zhvillua një tryezë diskutimi të cilës i paraprinë fjalët e shkurtra por kuptimplote të Barbara Burri Sharani dhe të Ruzhdi Ibrahimit. Ata pos tjerash vunë në thumb problematikën e Marrëveshjes ndërshtetërore për sigurimet shoqërore mes Zvicrës dhe Kosovës, gjë që kontribuon për përkeqësimin e mëtejshëm të situa të përgjithshme sociale të qytetarëve të Kosovës.

Pas prezantimit kronologjik që i bëri historiatit të kësaj problematike si dhe analizës sikur përmbajtjesore ashtu edhe juridike, specialisti i sigurimeve shoqërore, Ruzhdi Ibrahim përmbylli referimin e tij me përfundimin se është e evidente diskriminimi i pashembullt në Zvicër që u bëhet qytetarëve të Republikës së Kosovës. Vendime këto të plotfuqishme në favor të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe që tumirin zbatimin e Marrëveshjes, e të cilat refuzojnë ti zbatojnë Enti federal për sigurimet shoqërore e së fundi edhe vet Qeveria zvicerane. Ai po ashtu kritikoi edhe pasivitetin dhe injorimin e kësaj çështjeje nga ana e zyrtarëve dhe qeverisë së Kosovës. Diskutimet pasuese ku morën pjesë aktive edhe pjesëmarrësit nga po-diimi, kishin të bënin në njërin anë me problemet sociale në Kosovë, ndërsa në anën tjetër me Marrëveshjen në fjalë. Në këto diskutime u angazhuan aktivisht edhe punëtorët dhe aktivistët sindikal shqiptarë, ata portugezë e italianë, krahas sindikalistëve dhe politikanëve zviceranë.

Fatmir Bajrami



Aksident: A më takojnë paratë ditore në rast sëmundjeje për të dy vendet e mija të punës?

Unë punoj ka 10 vite në dy vende të ndryshme si ndihmëse shtëpiake. Tek Spitexi jam e punësuar për 15 orë pune në javë. Pos kësaj punoj në një amvisni private çdo herë nga 4 orë pune në javë. Të enjten e fundit kisha një aksident. Jam rrëzuar nga biçikleta dhe kam lënduar krahun e djathtë. Mjekja ime më ka dhënë dëshminë për paaftësi punë të plotë deri në fund të qershorit. A më takon kompensimi i pagës nga sigurimi aksidental?

Po. Në Zvicër të gjithë punëmarrësit janë siguruar në raste aksidenti. Ky sigurim mbulon aksidentet profesionale, ato joprofesionale si dhe sëmundjet profesionale. Për të punësuarit pjesërisht aksidentet jashtë ushtrimit të profesionit janë të siguruar detyrimisht vetëm atëherë kur orari javor i punës përbëhet së paku 8 orë. Kujdes: Kush punon për më shumë punëdhënës, nuk mundet të llogaritet të gjitha orët bashkë: Mbulesa e sigurimit në rast aksidenti në kohë të lirë ekziston vetëm në rastet kur personi është i punësuar vetëm tek njeri punëdhënës për së paku 8 orë në javë. Aksidentet që ndodhin gjatë rrugëtimit për në vend të punës janë gjithmonë të mbuluara. Dhe tani tek rasti juaj: Pasi që ju jeni e punësuar tek Spitexi për 15 orë pune në javë, ju takojnë për aksidentin me biçikletë përfitimet ligjore nga sigurimi aksidental: Se a ka ndodhur aksidenti rrugës për në punë apo në rast të shetitjes, kjo nuk luan ndonjë rol. Sigurimi aksidental i Spitexit mbulon detyrimisht përfitimin. Sigurimi duhet tu paguaj juve paratë ditore në lartësinë 80% të ardhurave të siguruar. Për përlogaritjen lartësisë së parave ditore, sigurimi ju paguan juve për të dyja të ardhurat e juaja bashkë.

Peter Schmid, work, 23.5.2013

Rrëzim në pauzë: Aksident pune

Para disa javësh derisa ishte kohe e ngrohtë dhe me diell, në patëm dëshirë të bëjmë pauzën në balkonin e restorantin interno të ndërmarrjes sonë. Duke dalë jashtë kam marrë thua dhe jam rrëzuar. Me këtë rast kam pësuar lëndime. Shefi im thëthë se nuk kemi të bëjmë me aksident pune. A është kjo e vërtetë?

Jo, kjo nuk qëndron. Si aksidente pune llogariten të gjitha aksidentet sikur gjatë pauzave ashtu edhe koha para dhe pas punës. Mirëpo vetëm atëherë, kur qëndrojmë në dispozicion në vendin e punës dhe kur ka një ndërlidhje mes aktivitetit dhe vendit të punës: Nëse dikush drekon në vendin e punës, apo bënë sport në hapësirat e ndërmarrjes dhe me këtë rast pëson aksident, edhe kjo llogaritet si aksident pune. Parakusht është që shefi të ketë lejuar këtë lloj aktiviteti. Kufiri i vendit të punës pasqyron gardhin e ndërmarrjes: Nëse nuk ka gardh, atëherë vlen kufiri i arealit pronësor edhe atij të marrë me qira. Rrugët që qojnë aty, të cilat përdoren edhe nga mjetet e komunikacionit publik, nuk llogariten si vend pune. Nëse punëdhënësi në një ndërtesë disakatëshe ka marrë vetëm një lokal me qira një zyre apo punëtori, atëherë nisja dhe përfundimi i kufirit të vendit të punës është dera hyrëse në ndërtesë.

Philip Thomas, work, 6.6.2013

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariasslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch